



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Zyra e Kryeministrit - Kancelarija Premijera - Office of the Prime Minister

**RREGULLORE (ZKM) NR. 05/2026 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE
SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË AKREDITIMIT TË KOSOVËS ¹**

¹ Rregullorja ZKM-Nr. 05/2026 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës është miratuar nga Kryeministri në detyrë me Vendimin Nr. 345/2026, të datës 26.01.2026

Kryeministri i Republikës së Kosovës

Në mbështetje të nenit 94 (paragrafi 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 9 (paragrafi 1.3) i Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neni 5 (paragrafi 4) i Ligjit Nr. 05/L-117 për Akreditim, neni 28 (paragrafi 3) të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore të Republikës së Kosovës, dhe neni 9 (paragrafi 7) të Rregullores Nr. 01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm, Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Bashkëpunimin në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura,

Nxjerr:

RREGULLORE (ZKM) NR. 05/2026 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË AKREDITIMIT TË KOSOVËS

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës, në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Neni 2 Fushëveprimi

Kjo rregullore zbatohet për Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ku kompetencat e përgjithshme për fushën e akreditimit përcaktohen me ligjin përkatës për akreditim, standardet ndërkombëtare si dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

KAPITULLI II ORGANIZIMI I BRENDSHËM I AGJENCISË

Neni 3 Misioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës

1. Misioni i DAK-së është ofrimi i shërbimeve të akreditimit në fushën e vlerësimit të konformitetit në nivel vendi, të rrisë ndërgjegjësimin për akreditim në shoqëri dhe të marrë një rol aktiv në përcaktimin e rregullave në infrastrukturën e cilësisë.

2. Vizioni i DAK-së është nënshkrimi dhe mirëmbajtja e marrëveshjeve të njohjes reciproke me organizmat evropiane dhe ndërkombëtare të akreditimit në fusha të ndryshme. DAK ofron shërbimin e akreditimit duke u mbështetur në parimet e akreditimit dhe duke siguruar besueshmërinë e klientëve të saj dhe të gjitha palëve të interesuara.

Neni 4

Struktura organizative e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës

1. Struktura organizative e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës (DAK) është si vijon:

1.1. Zyra e Drejtorit Ekzekutiv;

1.2. Divizionet.

2. Numri i të punësuarve në Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës është shtatëmbëdhjetë (17).

3. Shërbimet e përgjithshme do të kryhen nga dikasteret përkatëse të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Neni 5

Zyra e Drejtorit Ekzekutiv

1. Zyra e Drejtorit Ekzekutiv të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës, përbëhet nga:

1.1. Drejtori Ekzekutiv;

1.2. Një (1) Asistent/e administrativ;

1.3. Një (1) Zyrtar i Lartë i Sistemit të Cilësisë.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit Ekzekutiv përcaktohen sipas ligjit përkatës për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, si dhe me kërkesat e standardit ISO/IEC 17011 dhe ligjin përkatës për akreditim.

3. Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrtarit Administrativ të Zyrës së Drejtorit Ekzekutiv përcaktohen sipas legjislacionit përkatës për zyrtarë publikë.

4. Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrtarit të Lartë të Sistemit të Cilësisë përcaktohen sipas ligjit përkatës për zyrtarë publik, legjislacionit tjetër përkatës në fuqi dhe me kërkesat e standardit ISO/IEC 17011.

5. Numri i të punësuarve në Zyrën e Drejtorit Ekzekutiv është tre (3).

Neni 6 Divizionet

1. Në kuadër të kësaj drejtorie bëjnë pjesë divizionet si në vijim:

1.1. Divizioni për Laboratorë Testues, Kalibrues dhe Mjekësorë.

1.2. Divizioni për Trupa Inspektues dhe Certifikues, dhe

1.3. Divizioni për Zhvillim dhe Promovim.

2. Numri i të punësuarve në tri divizione është 14.

Neni 7 Divizioni për Laboratorë Testues, Kalibrues dhe Mjekësorë

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Laboratorë Testues, Kalibrues dhe Mjekësorë janë:

1.1. Divizioni ofron shërbimin e akreditimit të laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësorë;

1.2. Bashkëpunon me Divizionin e Trupave Inspektues dhe Certifikues dhe Divizionin për Zhvillim dhe Komunikim, dhe Zyrtarin e Lart për Cilësi për zbatimin e detyrave që rrjedhin nga sistemi i menaxhimit;

1.3. Divizioni ka përgjegjësinë të organizojë procesin e akreditimit të laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësorë në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe me kompetencë në përputhje me aktet ligjore në fuqi, standardet e akreditimit, rregulloret dhe procedurat e akreditimit të miratuara nga DAK;

1.4. Divizioni posedon analizën e burimeve, identifikon nevojën për kryevlerësues/vlerësues teknik/ekspert teknik në fushat përkatëse, identifikon nevojën për dokumentacionin e nevojshëm dhe propozon fillimin e procedurave të zgjerimit të fushave të akreditimit;

1.5. Ndjek ndryshimet në standardet dhe dokumentet ndërkombëtare në fushën e akreditimit dhe propozon implementimin e tyre në sistemin e menaxhimit të DAK-së;

1.6. Zbaton programin e vlerësimit për çdo TVK duke u bazuar në analizën e rreziqeve;

1.7. Divizioni operon sipas detyrave që rrjedhin nga zbatimi i sistemit të menaxhimit të DAK-së.

2. Udhëheqësi i Divizionit për Laboratorë Testues, Kalibrues dhe Mjekësorë raporton tek Drejtori Ekzekutiv i DAK-ut.

3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Laboratorë Testues, Kalibrues dhe Mjekësorë është gjashtë (6).

Neni 8 **Divizioni për Trupa Inspektues dhe Certifikues**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Trupa Inspektues dhe Certifikues janë:

1.1. Divizioni ofron shërbimin e akreditimit të trupave inspektues dhe certifikues;

1.2. Bashkëpunon me Divizionin e Laboratorëve Testues, Kalibrues dhe Mjekësorë, Divizionin për Zhvillim dhe Komunikim dhe Zyrtarin e Lart për Cilësi, për zbatimin e detyrave që rrjedhin nga sistemi i menaxhimit;

1.3. Divizioni ka përgjegjësinë të organizojë procesin e akreditimit të Trupave Inspektues dhe Certifikues në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe me kompetencë në përputhje me aktet ligjore në fuqi, standardet e akreditimit, rregulloret dhe procedurat e akreditimit të miratuara nga DAK;

1.4. Divizioni posedon analizën e burimeve, identifikon nevojën për kryevlerësues/vlerësues teknik/ekspert teknik në fushat përkatëse, identifikon nevojën për dokumentacionin e nevojshëm dhe propozon fillimin e procedurave të zgjerimit të fushave të akreditimit;

1.5. Ndjek ndryshimet në standardet dhe dokumentet ndërkombëtare në fushën e akreditimit dhe propozon implementimin e tyre në sistemin e menaxhimit të DAK-së;

1.6. Zbaton programin e vlerësimit për çdo TVK duke u bazuar në analizën e rreziqeve;

1.7. Divizioni operon sipas detyrave që rrjedhin nga zbatimi i sistemit të menaxhimit të DAK-së.

2. Udhëheqësi i Divizionit për Trupa Inspektues dhe Certifikues raporton tek Drejtori Ekzekutiv i DAK-ut.

3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Trupa Inspektues dhe Certifikues është pesë (5).

Neni 9 **Divizioni për Zhvillim dhe Promovim**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Zhvillim dhe Promovim janë:

1.1. Zgjerimi i aktiviteteve të DAK-së dhe zhvillim i skemave të reja për akreditim;

1.2. Mirëmbajtja dhe monitorimi i vlerësuesve/kryevlerësuesve dhe ekspertëve teknikë, aktiviteti i këshilleve dhe grupeve teknike të punës;

1.3 Promovimi i akreditimit;

- 1.4 Menaxhimi i uebfaqes dhe rrjeteve sociale;
 - 1.5 Organizimi i trajnimeve, seminare, evente në lidhje me akreditimin;
 - 1.6 Gjetja dhe ndjekja e projekteve, përcjellja e zhvillimeve të dalura nga EA, ILAC dhe IAF;
 - 1.7 Bashkëpunon me Divizionin e Laboratorëve Testues, Kalibrues dhe Mjekësorë, divizionin e trupave Inspektuese dhe Certifikuese, dhe Zyrtarin e Lart për Cilësi për zbatimin e detyrave që rrjedhin nga sistemi i menaxhimit;
 - 1.8. Në koordinim me grupet teknike përkatëse të punës raportimi tek Drejtori Ekzekutiv në lidhje me shkallën e plotësimit të kërkesave nga aplikuesi mbi validimin e skemave të akreditimit dhe vlerësimit të konformitetit si dhe propozon zgjerimin e aktivitetit të DAK dhe skemat e reja për akreditim si dhe masat për implementimin e tyre;
 - 1.9. Divizioni operon sipas detyrave që rrjedhin nga zbatimi i sistemit të menaxhimit të DAK-së.
2. Udhëheqësi i Divizionit për Zhvillim dhe Promovim raporton tek Drejtori Ekzekutiv i DAK-ut.
 3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Zhvillim dhe Promovim është tre (3).

KAPITULLI III DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE SHFUQIZUESE

Neni 10 Dispozita kalimtare

1. Rritja apo zvogëlimi i numrit të personelit në pajtim me ligjin vjetor të buxhetit nuk krijon nevojë për plotësim-ndryshimin e kësaj Rregulloreje, përpos në rastet kur krijohen dhe/apo shuhet strukturat organizative.
2. Në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, dispozitat e ligjit vjetor të buxhetit janë pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.

Neni 11 Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohen nenet 46 deri 50 të Rregullores Nr. 29/2012 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Neni 12
Hyrja në Fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin Kurti

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Datë: 26 janar 2026

Organogrami i Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës				
Pozicioni/Struktura	Klasa	Grupi (i përgjithshëm ose i veçantë)	Nr.	Total
1. Zyra e drejtorit të përgjithshëm				3
Drejtori i përgjithshëm	Drejtues/e i/e Lartë		1	
Asistent/e administrative	Profesional 3	64. Grupi i administrimit të përgjithshëm	1	
Zyrtar i Lartë i Sistemit të Cilësisë	Specialist	11. Grupi i shkencave natyrore	1	
2. Divizioni për Labororë Testues, Kalibrues dhe Mjekësorë				6
Udhëheqës i Divizionit për Labororë Testues, Kalibrues dhe Mjekësorë	Drejtues/e i/e Ulët		1	
Zyrtar/e i/e Lartë për Akreditimin e Labororëve Testues	Specialist	11. Grupi i shkencave natyrore	3	
Zyrtar/e i/e Lartë për Akreditimin e Labororëve Kalibrues	Specialist	33. Grupi i inxhinierisë industriale	1	
Zyrtar/e i/e Lartë për Akreditimin e Labororëve Mjekësorë	Specialist	11. Grupi i shkencave natyrore	1	
3. Divizioni për Trupa Inspektues dhe Certifikues				5
Udhëheqës i Divizionit për Trupa Inspektues dhe Certifikues	Drejtues/e i/e Ulët		1	
Zyrtar/e i/e Lartë për Akreditimin e trupave inspektues	Specialist	11. Grupi i shkencave natyrore	2	
Zyrtar/e i/e Lartë për Akreditimin e trupave certifikues	Specialist	11. Grupi i shkencave natyrore	2	
4.Divizioni për Zhvillim dhe Promovim				3
Udhëheqës i Divizionit për Zhvillim dhe Promovim	Drejtues/e i/e Ulët		1	
Zyrtar/e i/e Lartë për Promovim dhe Zhvillim	Profesional 1	12. Grupi i shkencave shoqërore	2	

Organogrami i Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës

